



INICIATIVA E ITINERARIT KULTUROR

“Një proces bashkëpunues dhe i bazuar në komunitet që promovon shfrytëzim dhe menaxhim të përgjegjshëm të resurseve lokale nga komunitetet lokale”



Support to the Promotion of Cultural Diversity

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe



ITINERARI KULTUROR I KOSOVËS

"Një proces bashkëpunues dhe i bazuar në komunitet që promovon shfrytëzim dhe menaxhim të përgjegjshëm të resurseve lokale nga komunitetet lokale"



Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë'. Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

Duke punuar në drejtim të ndërtimit të Itinerarit Kulturor të Kosovës* Perëndimore ku komunitetet dhe vizitorët

- Vijnë dhe vizitojnë strukturat tradicionale nga guri
- Përjetojnë praktikat kulturore lokale
- Shijojnë pije dhe ushqim të veçantë duke kaluar kohë me familjen e tyre
- Vlerësojnë natyrën e bukur, sportet dhe artet në një mjedis natyror



* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



HYRJE

'Itinerari Kulturor i Kosovës Perëndimore' është një inspirim dhe dëshmi e diversitetit të pasur me peizazhe, njerëz dhe trashëgimi të Kosovës, që paraqet një potencial që ngjallë kureshtjen për turizëm në rajon. Kjo iniciativë ofron një numër të veprimeve inovative, duke u mbështetur në resurse lokale dhe duke i shfrytëzuar ato derisa në të njëjtë kohë përmirëson cilësinë, dizajnin dhe prezantimin e produkteve. Duke vepruar kështu, kjo shton edhe një dimension të edukimit publik, ku rritet vetëdija për vlerat dhe shfrytëzimin e përgjegjshëm të resurseve për gjeneratat e ardhshme. Një ndjenjë e krenarisë së të qenit nga një vend dhe traditat e saj janë ngushtë të lidhura me praktikën ditore të jetës së popullatës lokale dhe marrëdhëniet e tyre me rrethinën. Prandaj, Itinerari Kulturor është i hareshëm, arsimor dhe zbavitës dhe në të njëjtën kohë vlerëson kulturat lokale, pasuritë e trashëgimisë dhe çon në praktikë dinamike dhe të shëndosha ekonomike.

'Itinerari Kulturor i Kosovës Perëndimore' stimulon integrimin rajonal përmes iniciativave të përbashkëta nga komunitetet dhe komunat e përfshira duke inkurajuar respektimin e të drejtave kulturore, demokracinë kulturore dhe diversitetin, duke vlerësuar trashëgiminë e përbashkët dhe duke i kontribuar parimeve fundamentale evropiane për një kuptim më të mirë.

SFONDI

Kjo iniciativë rrjedh nga Plani i Trashëgimisë së Kosovës Perëndimore, lansuar nga projekti i Përbashkët i BE/KiE Mbështetja e Promovimit të Diversitetit Kulturor (PDKK) në vitin 2012, me synim të demonstrimit të metodave të mundshme të ngritjes së vetëdijes dhe të zhvillimit gradual social e ekonomik duke u bazuar në resurset lokale ekzistuese. Shtigjet Kulturore menaxhohen nga komunitetet lokale me një qasje të integruar dhe përfshirëse.

Hulumtimet e kohëve të fundit të bëra rreth potencialit të trashëgimisë dhe seancat e diskutimit të bëra me palët me interes lokale kanë konkluduar se vënia e theksit në aspektet

specifike të resurseve ekzistuese të cilat janë të njohura për komunitetet mund të jetë një pikë e mirë nismëtare. Për më tepër, kjo do të krijonte një platformë të dobishme për aktivitetet e zhvillimit lokal të rajonit. Ky hulumtim, që është bërë nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar në gjashtë komuna, është fokusuar në tema specifike në secilin qytet si pjesë e iniciativës së itinerareve kulturore.

Kjo analizë preliminare drejt zhvillimit të iniciativave vendos themelet e programit, të cilat inkurajojnë skemat e partneritetit potencial publik – privat. Aktivitetet e propozuara kanë karakteristika specifike që kontribuojnë në zhvillimin e turizmit lokal të trashëgimisë por luan edhe rol kolektiv si tërësi. Fuqia e vet vjen nga puna me iniciativat tanimë ekzistuese dhe të vetme, duke shfrytëzuar hulumtimet e bëra mirë në secilën temë, dhe synimin për të përfshirë disiplina të ndryshme.

MISIONI DHE VIZIONI

Duke u inspiruar nga shtigjet kulturore të Këshillit të Evropës (KiE), zbatimi i këtij programi ka filluar në vitin 2014 me një vizion afatgjatë të zhvillimit të shtigjeve kulturore mbi strukturat e gurit në bashkëpunim me vendet fqinje. Fillimisht, PDKK ishte përqendruar në itineraret kulturore në gjashtë komuna të Kosovës perëndimore me qëllim të vlerësimit të realizueshmërisë së këtij vizioni. Në të ardhmen e menjëhershme, secila komunë me temën e vet të veçantë të itinerarit kulturor planifikohet të bëhet një bosht ku praktikuesit, komunitetet lokale, hulumtuesit dhe institucionet mund të kontribuojnë dhe të lidhen me industrinë kreative.

Hapat e ardhshëm kërkojnë hulumtime të vazhdueshme të cilat me angazhimin aktiv të komunitetit për përgatitjen e itinerareve për të marrë vendin e vet në mënyrë graduale në listën e destinacioneve turistike të Kosovës. Programi synon të përparojë në mënyrë organike me pjesëmarrjen aktive dhe lidhësinë e komunitetit duke promovuar kulturën dhe trashëgiminë e Kosovës perëndimore dhe duke ofruar itinerar atraktiv.



TËRËSIA

Edhe pse secila iniciativë do të vepronte si një program i vetëm, tërësia e të gjitha programeve do të krijonte një sinergji dhe do të përbënte një atraksion të përgjithshëm për rajonin. Temat e zgjedhura për zhvillimin e një itinerari kulturor/rrjet të rajonit ka dalë nga specifikat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit si dhe nga gatishmëria e shprehur e palëve lokale me interes që të jenë pjesë e zhvillimit të një programi të tillë. Parakushtet bazë për zbatim të suksesshëm të një programi janë mbështetur në pilot veprimet e përfunduara si dhe nga observimet e potencialit të trashëgimisë të bërë nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.

FOKUSI I PROGRAMIT

Junik: Strukturat e gurit do të rehabilitohen dhe zhvillohen si atraksion turistik dhe do të ofrojnë arsimim profesional për rehabilitim të trashëgimisë.

Gjakovë: Praktikat dhe produktet atraktive të trashëgimisë kulturore të paprekshme do të promovohen dhe në të njëjtën kohë do të zhvillohen zanatet tradicionale.

Pejë: Sportet në natyrë dhe lojërat tradicionale do të promovohen duke ofruar një ofertë të veçantë turistike dhe duke vlerësuar bukuritë e maleve të Rugovës.

Klinë: Trashëgimia natyrore, biodiversiteti dhe artet performuese do të jenë në fokus përmes zhvillimit të ngjarjeve arsimore, kulturore dhe vetëdijësuese në një mjedis natyror.

Deçan: Do të krijohet një bibliotekë me lojëra të fëmijëve që do të prezantojë trashëgiminë përmes lojës, tregimeve dhe performancave.

Istog: Ushqimi tradicional & gastronomia e rajonit do të promovohen përmes prezantimit dhe prodhimit cilësor.

KRITERET

Disa prej elementeve kryesore të marra parasysh gjatë zhvillimit të programit dhe ndërtimit të rrjetit janë:

- Potenciali i trashëgimisë i zonave kulturore/natyrore, vendeve, ngjarjeve ose produkteve duhet të njihen nga komuniteti si trashëgimi e përbashkët;
- Pasuritë e përzgjedhura të trashëgimisë duhet të jenë të qasshme, në dispozicion dhe cilësore;
- Duhet të sigurohet përkrahja dhe përfshirja e komunitetit në zhvillim dhe përmirësim të trashëgimisë;
- Duhet të zhvillohen politikat publike për planifikim, menaxhim dhe vlerësim të pasurive të trashëgimisë në nivel lokal dhe qendror;
- Duhet të bëhet arsimimi dhe trajnimi rreth vlerës dhe potencialit të trashëgimisë për pronarët e trashëgimisë, bizneseve lokale, fëmijëve të shkollave dhe palëve tjera me interes përmes aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve.





PROGRAMI PËR REHABILITIM DHE EDUKIM PËR STRUKTURAT E GURIT NË **JUNIK**

Komuna e Junikut është e njohur për strukturën e saj prej gurit – kullave të rrethuara me mure prej guri si dhe me bukuri natyrore. Si struktura të bukura tradicionale në këtë mjedis rural, strukturat e gurit duhet të njihen gjerësisht si tipare të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit kulturor. Një qendër për restaurim dhe rehabilitim të trashëgimisë arkitektonike me elemente plotësuese të natyrës dhe tregime të njerëzve të rrënjësura në programin “Gurët që Flasin”, iniciuar nga PDKK, është një hap i rëndësishëm drejt vizionit afatgjatë për bërjen e Junikut “Qytet të Gurit”.





Programi përkrahë

Aktivitetet që demonstrojnë potencialin e Junikut si destinacion specifik të turizmit. Thënë në mënyrë më specifike, aktivitete arsimore që krijojnë njohuri, shkathtësi dhe praktika në restaurimin dhe rehabilitimin e strukturave të gurit; iniciativat e komunitetit dhe pjesëmarrja aktive në zhvillimin e turizmit kulturo; revitalizimi dhe avancimi i praktikave tradicionale lokale.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Janë bërë studime në strukturat e gurit për Planin Urban të Zhvillimit Lokal. Është zhvilluar një rast studimor për rehabilitim në bazë të një njësie urbane në lagjen e kullës së restauruar të Vehbi Ukë Isufaj, që është selia aktuale e Qendrës Rajonale të Turizmit në Junik. Aktivitetet e promovimit të potencialit të strukturave të gurit janë organizuar për autoritetet komunale dhe anëtarët e komunitetit dhe me miratimin e komunës dhe grupit konsultativ të komunitetit është zhvilluar një propozim program për një kamp veror dhe shkollë verore.

Hapat e ardhshëm

- Fushata për kërkim të fondeve për zbatim të programit të kampit veror/shkollës verore;
- Punëtoria me pronarët/zotëruesit e objekteve të përzgjedhura për rehabilitim;
- Punëtori dhe trajnime për përfaqësuesit e komunitetit lokal të interesuar për të marrë pjesë në aktivitete të programit;
- Detajizimi i programit arsimor dhe të rehabilitimit;
- Marrëveshja me pronarët/zotëruesit rreth punëve rehabilituese që duhet realizuar;
- Zhvillimi i kapaciteteve të një OJQ-je lokale për të organizuar dhe zbatuar programin e kampit veror dhe të shkollës verore;
- Vendosja e kampit veror në Kodrën e Moronicës;
- Projekti për dizajnimin e zonës së tregut dhe aktivitetet e tregut;
- Plani i veprimit dhe operacional për të filluar me zbatimin e programeve.



Qendra Rajonale e Turizmit, oborri



Qendra Rajonale e Turizmit, Junik



Amfiteatri në Parkun Moronica



TRASHËGIMIA JOMATERIALE DHE ARTIZANATET NË GJAKOVË

Gjakova është e njohur mirë për Çarshinë e Vjetër si një prej tregjeve të tregtisë më të zhvilluara orientale në Ballkan. Edhe pse trashëgimia arkitektonike e Çarshisë vërehet lehtë, zanatet tradicionale të Çarshisë janë duke u zhdukur ngadalë. Ri-vitalizimi i praktikave dhe zanateve tradicionale do të promovojnë dialogun ndër-kulturor nëpër gjenerata dhe do të ngritë vetëdijen për praktikat e çmueshme në rrezik për tu zhdukur, ku do të potencohet bartja e këtyre shkathtësive tek gjeneratat e reja. Rritja e interesit dhe atraksionit do të ngritë edhe interesimin për industritë kreative që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal. Me vizionin që industria e zanateve lokale të bëhet kontribues i vlefshëm në ekonominë e rajonit perëndimor, kjo iniciativë do të punojë me tërë rajonin e Kosovës perëndimore duke përqafuar njohuritë lokale, praktikuesit dhe vlerat tradicionale si resurse dhe duke marrë një rol të veçantë në itineraret kulturore.



Programi përkrahë

Ngritjen e kapaciteteve të asociacionit të zanatlinjve me qëllim të zhvillimit, menaxhimit dhe promovimit të praktikave të zanateve në rajon me qendrën strategjike të vendosur në zonën e Çarshisë. Në kombinim me veprimet plotësuese, programet rajonale me praktikues dhe gjeneratat e reja do të zhvillohen me ngjarje atraktive duke rritur kësisoj vlerën unike të qytetit dhe të rajonit.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Janë organizuar pilot veprimet për promovimin e zanateve si elemente të paprekshme të trashëgimisë kulturore. Është bërë një vlerësim i praktikuesve të zanateve tradicionale rreth perspektivës së praktikës dhe prodhimit të tyre dhe janë organizuar aktivitete të ngritjes së vetëdijes për të promovuar nevojën për ruajtje të autenticitetit dhe funksionimit të Çarshisë. Po ashtu, është bërë një studim rreth potencialit të Çarshisë për zhvillim ekonomik lokal dhe janë identifikuar veprimet fillestare.

Hapat e ardhshëm

- Adaptimi i kullës së restauruar, që ndodhet afër Çarshisë, si seli kryesore e veprimit;
- Zhvillimi i një programi për zanate specifike për të promovuar “brendë”, sëpari në Çarshinë e Gjakovës dhe gradualisht duke përfshirë tërë rajonin perëndimor;
- Organizimi i punëtorive për ngritje të vetëdijes së publikut rreth potencialit të zanateve tradicionale si një prej prioriteteve për industritë kreative dhe zhvillimin e turizmit;
- Dizajnimi i një programi për evente/ngjarje promovuese në Çarshi;
- Organizimi i pilot veprimeve/eventeve, bashkë me praktikuesit dhe asociacionet e rajonit, për zbatim të programit për “brendim” të zanatave.



Qarshija e Vjetër në Gjakovë



Zeja e Poçarisë



Zeja e djep punuesit



SPORTET E JASHTME DHE FESTIVALET ME LOJËRA TRADICIONALE NË PEJË

Malet e Rugovës me shpellat, grykat, liqenet dhe lumenjtë e saj është e njohur si një prej fushave më atraktive të rekreacionit për njerëzit në Kosovë. Përveç sporteve të jashtme në mjedisin natyror të cilat janë praktikuar kohë më parë, siç janë ecja, ngjitja dhe skijimi, ka iniciativa për promovim të sporteve alternative siç janë kajaku, lëshimi me litar nëpër grykë dhe zbulimi i shpellave që më parë ishin të paqasshme. Ky peizazh mbresëlënës malor ka inspiruar vazhdimisht popullatën lokale duke krijuar një numër të shumtë të tregimeve interesante të cilat pasqyrohen përmes festivalit të lojërave tradicionale, të njohura si “Lojërat e Rugovës”. Peja, bashkë me një numër të atraksioneve të trashëgimisë në qytet, do të jetë pika e itinerarit për lojërat tradicionale dhe sporte natyrore për tërë rajonin e Kosovës përëndimore.

Programi përkrahë veprimet për zhvillimin dhe menaxhimin e një programi për promovimin e sporteve natyrore në rajon. Veç kësaj, prioritet do të jetë adaptimi i Mullirit Tradicional të Haxhi Zekës, si bazë për aktivitete dhe qendër trajnuese për sporte të jashtme dhe lojëra tradicionale.





Aktivitetet e realizuara deri tani

Festivali i “Lojërave të Rugovës” është përkrahur dhe është përgatitur një propozim për “Program Rajonal për Sporte të Jashtme dhe Rekreacion” nga ekspertët lokal. Janë organizuar pilot veprime rreth promovimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Pejës. Është bërë vlerësimi preliminar rreth gjendjes së kompleksit arkitektonik të Mullirit të Haxhi Zekës.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Festivali i “Lojërave të Rugovës” është përkrahur dhe është përgatitur një propozim për “Program Rajonal për Sporte të Jashtme dhe Rekreacion” nga ekspertët lokal. Janë organizuar pilot veprime rreth promovimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të Pejës. Është bërë vlerësimi preliminar rreth gjendjes së kompleksit arkitektonik të Mullirit të Haxhi Zekës.

Hapat e ardhshëm

- Zhvillimi i një projekti për adaptimin e Mullirit të Haxhi Zekës në një qendër të trajnimit;
- Krijimi i një programi për sporte të jashtme/natyrore në bazë të raportit të ekspertëve;
- Identifikimi i një subjekti që do të menaxhonte programin në koordinim me iniciativat tjera në rajon;
- Organizimi i eventeve me qëllim të hulumtimit dhe promovimit të lojërave tradicionale dhe sporteve natyrore në tërë rajonin e Kosovës përëndimore, përfshirë festivalin e “Lojërave të Rugovës”.





TRASHËGIMIA NATYRORE, BIODIVERSITETI DHE ARTET PERFORMUESE NË **KLINË**

Komuna e Klinës është e pasur me peizazhet e saja natyrore, përfshirë 6 lumenj dhe diversitet të pasur si dhe me popullatë diverse, e vendosur në udhëkryqin qendror të Kosovës. Ujëvarat atraktive të Mirushës dhe shpellat në rrethinë janë njohur si potencial për zhvillimin e zonës, derisa lokacione arkeologjike janë zbuluar gjatë hulumtimeve të kohëve të fundit në atë zonë.

Klina ka karakteristika të veçanta që mundësojnë zbatimin potencial të Konventës Evropiane për Peizazhet, ku peizazhet dhe pushimi bashkohen në harmoni dhe ofrojnë një mundësi për popullatën vendore dhe vizitorët. Aktivitetet e bëra nga projekti i PDKK-së, të kryera në partneritet me komunën dhe organizatat e shoqërisë civile, potencojnë resurset ekzistuese dhe shfrytëzimin e përgjegjshëm që kontribuojnë në promovimin e diversitetit natyror dhe ngritjen e vetëdijes për shfrytëzimin e përgjegjshëm të saj. Iniciativa e paraparë për arte performuese në një mjedis natyror të aranzhuar dhe të mirëmbajtur mirë do të ofrojnë një atraksion kulturor për komunitetin në zonat rurale dhe urbane si dhe për turistët nga Kosova.



Programi përkrahë

Krijimin e një qendre edukative mostër dhe një program për ruajtje të mjedisit dhe biodiversitetit natyror në një objekt të caktuar. Aktivitetet rehabilituese për zonën e caktuar dhe një studim i fizibilitetit për Artet Performuese, kombinuar me programin, do të vënë themelet për hapat e ardhshëm në tërë rajonin e Kosovës perëndimore. Observatori i paraparë i Peizazheve do të ishte një aset për Kosovën për të vlerësuar dhe menaxhuar pasuritë e saja në mënyrë efektive.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Është bërë një vlerësim preliminar rreth biodiversitetit, një listë e peizazheve dhe një vlerësim i aktiviteteve arsimore. Lista e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore e komunës me pilot veprime për promovimin e këtyre pasurive ishte përkrahur në fazën fillestare. Është identifikuar një lokacion për rehabilitimin e një “kulle nga tullat” në periferi të Klinës, që do të shfrytëzohet si Observator i Peizazheve. Janë bërë konsultime me autoritetet lokale dhe qendrore rreth potencialit të biodiversitetit të trashëgimisë natyrore dhe peizazheve.

Hapat e ardhshëm

- Studim rastit rreth rehabilitimit të një zone të caktuar (zona përgjatë lumenjve Klina dhe Drini i Bardhë);
- Lansimi i iniciativës për themelimin e një qendre edukative me pjesëmarrjen aktive të autoriteteve lokale, përfaqësuesve të shkollave lokale dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Punëtori edukimi rreth biodiversitetit;
- Projekti për rehabilitim të “kullës së tullave” për t'u përdorur si Observator i Peizazheve me përkrahje të veçantë nga MKRS;
- Studimi i fizibilitetit për Artet Performuese dhe zhvillim të programit.



Kulla e Jakajve në fshatin Ranoc, Klinë



Ujërrë e bardhë, Klinë



Lumi Drini i Bardhë, Klinë



LOJËRAT E FËMIJËVE DHE PERFORMANCAT NË DEÇAN

Vendi ku gjendet një Objekt i Trashëgimisë Botërore, peizazhet malore mbresëlënëse dhe shumë lloje tradicionale të kullave (shtëpive) të gurit. Komuna e Deçanit ka potencial të madh me resurset e veta ekzistuese. Edhe pse rehabilitimi i shtëpive tradicionale ka qenë prioritet për një kohë, rritja e numrit të ngjarjeve kulturore dhe aktiviteteve afariste janë duke hapur një perspektivë të re kulturore dhe ekonomike për këtë zonë; me rituale unike përfshirë qethjen e deleve, lojëra tradicionale dhe festivale tjera si Festival i Gështenjave. Produktet lokale që prodhohen nga komunitetet lokale përfshirë Manastirin e Deçanit ofrojnë mundësi të llojllojshme për vizitorët. Iniciativa e Itinerareve Kulturore e sheh këtë zonë si mundësi të madhe për arsimim të fëmijëve, përmes krijimit të një biblioteke të lojërave të fëmijëve si një vend atraktiv për fëmijët dhe familjet e tyre, ku do të organizoheshin lojëra dhe performanca të shoqëruara me trashëgimi kulturore të prekshme dhe të paprekshme.





Programi përkrahë

Adaptimin e brendshëm dhe të jashtëm të “kullës” për bibliotekën e lojërave të fëmijëve dhe trajnimin e stafit për përzgjedhje dhe prodhim të lojërave përkatëse dhe programit të fëmijëve. Veç kësaj, do të inkurajohet përfshirja e lagjes në aktivitete dhe iniciativa anësore.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Është bërë një vlerësim preliminar i ndërtesave të përzgjedhura dhe janë mbajtur konsultime rreth iniciativës me palët lokale me interes. Janë organizuar pilot veprime për promovim të pasurisë së trashëgimisë në komunë Deçanit dhe është zhvilluar një propozim i programit për lojëra të fëmijëve

Hapat e ardhshëm

- Trajnimi i kuadrove;
- Adaptimi i lokacionit për funksionin e ri, në bashkëpunim me autoritetet;
- Krijimi i bibliotekës së lojërave të fëmijëve;
- Dizajnimi i lojërave të përzgjedhura;
- Prezantimi i programit në shkollat e interesuara për të marrë pjesë në aktivitete;
- Organizimi i fqinjëve për ndërmarrësi të vogël, përfshirë ushqimet dhe suveniret;
- Koordinimi i vizitave.



Lojëra të fëmijëve



Lojëra të fëmijëve



Kulla e Mushkolajve në Deçan



USHQIMI TRADICIONAL & GASTRONOMIA NË ISTOG

Si pjesë përbërëse e kulturës së komunitetit, ushqimi tradicional çdo herë varet nga ajo se çka ofron natyra në një rajon të veçantë. Për shkak të kushteve të favorshme klimatike, zona e gjerë e komunës së Istogut është e njohur për kultivim të peshkut dhe pemishteve të mollës. Komunitetet lokale festojnë kohën e të korrave dhe ndajnë ushqimin ndërmjet vetes përmes darkës tradicionale të quajtur “Darka e Lamës”. Tavolina e pasur që feston llojllojshmërinë e ushqimeve dhe pijeve është një inspirim për zgjerim të fokusit në tërë rajonin dhe për promovim të produkteve lokale dhe përgatitjen tradicionale e prezantimin e tyre. Itineraret kulturore shpresojnë të punojnë me komunitetet lokale të rajonit dhe të bëjnë produktet e tyre brende në mënyrë sistematike dhe të llojllojshme duke tërhequr vizitorë me mikpritjen unike që ofrojnë ata.





Programi përkrahë

Një studim të fizibilitetit për brendim të produkteve dhe specialiteteve tradicionale të gastronomisë. Identifikim dhe adaptim të enterierit të objekteve të përzgjedhura për prezantim të produkteve, testim dhe kurse gatimi që pritet të inspirojnë komunitetet lokale dhe vizitorët e të gjitha moshave. Do të përkrahen fushata për të rritur interesimin e banorëve lokal rreth përfitimeve të përfshirjes së tyre në proces si veprime të menjëhershme.

Aktivitetet e realizuara deri tani

Festivali Vjetor i të Korrave (Mollës) ishte mbështetur për të testuar si mostër rezultatet e një veprimi të tillë. Analiza e Ushqimit Tradicional në Rajonin Perëndimor është bërë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Është bërë edhe një vlerësim i kushteve të ndërtesës tradicionale (kullës) si vend potencial për promovim të ushqimeve dhe pijeve tradicionale.

Hapat e ardhshëm

- Projekti për restaurim të objektit që duhet të rehabilitohet në një dyqan, restorant dhe vend ku do të organizoheshin kurse gatimi;
- Promovimi i iniciativës tek palët lokale me interes, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Arsimit;
- Përkrahja teknike për zhvillimin e një programi për qasje bashkëpunuese në rajon, prodhimin e produkteve të llojllojshme me cilësi dhe prezantim, brendimin e produkteve, praktikave dhe ritualeve për atraksion turistik.



Darkë e Lamës, Istog



Festivali i mollës, Istog



Kulla e Zenel Salihaj në fshatin Shushicë, Istog



DEKLARATË PËRMBYLLËSE

Esenca e iniciativës është të promovojë një rrjet zhvillimor të rajonit bashkë me palët me interes të përfshira në tërë territorin duke inkurajuar hulumtime për përmirësim të vazhdueshëm. Pas caktimit të itinerareve dhe përcaktimit të palëve me interes të përfshira, çdo pikë e itinerarit do të jetë një platformë për palët lokale me interes rreth së cilës do të mbledhen për një prodhim dhe marketing të përbashkët.



◆◆◆ www.coe.int/pcdk ◆◆◆

Support to the Promotion of Cultural Diversity

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe